

VENDIM
Nr. 519, datë 29.7.2022

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 111, DATË 2.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:
 - a) Në pikën 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019."
 - b) Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

"3.1 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj edhe në këto fusha:

 - a) Ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:
 - i. hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara;
 - ii. planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;
 - iii. drejtimin dhe koordinimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;
 - iv. ndjekjen, koordinimin, monitorimin e zbatimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të ngarkuara autoriteteve përgjegjëse në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, për rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.
 - b) Kontakton dhe bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për:
 - i. prezantimin e gjendjes dhe të dëmeve të shkaktuara;
 - ii. përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë e programeve të procesit të rindërtimit;
 - iii. detajimin e nevojave dhe paraqitjen e kërkesave për donacione financiare dhe mbështetje të specializuar njerëzore;
 - iv. informimin e secilit prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre."
 - c) Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

"4.1 Vendimi nr. 650, datë 3.11.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave", shfuqizohet."
 2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama